



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Mbledhja nr. 39/18
Prishtinë, më 19.12.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen e morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Enver Hoti, Blerim Kuqi dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Jelena Bontic.

Pjesëmarrës i ftuar: Besnik Tahiri - Koordinator për Reforma Shtetëror në Qeverinë e Kosovës.

Pjesëmarrës tjerë: Albulena Haxhiu-deputete, Ruzhdim Morina – Kryesuesi i Bordit të FPKP-së, Valdrin Osmanaj-anëtar i Bordit FPKP, Adrian Zalli- drejtor menaxher FPKP, Florije Kika zëvendës-drejtor në AKKVP, Arben Ibrahimaj – UDZKA në AKKVP, Vatra Qehaja nga GPLVV, Arvita Zyferi-NAP- ZKA, Faruk Rrahmani-ZKA, Adnan Rustemi-anëtar i KQZ-së-LVV, Sylejman Sylejmani - Gazetar nga Infokus, Ardita Hajra – Aktiv, Arzu Sopi gazetare nga kallxo.com, Blendi Sopi - monitorues nga KDI, Agnesa Haxhiu-monitorues nga KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku – Kryetar (tutje kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 21, 30 nëntor dhe 5 dhjetor 2018;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-097 për bibliotekat dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;**

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/22 për kinematografinë dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
9. Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2019;
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2017;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i i rendit të ditës

Kryetari: Para se ta aprovojmë këtë rend të ditës dua të propozojë tri pika shtesë, dy të parat janë raportet e komisionit tonë për Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale dhe të korporatave. Komisionet tjera të përhershme i kanë shqyrtuar projektligjet dhe amendamentet e propozuara dhe nuk kanë ndonjë vërejtje. Pika e tretë është shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale dhe amendamenteve të komisionit funksional për Legjislacion, në aspektin e ndikimit financiar.

Kryetari: Konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, me plotësimin e tri pikave të reja: Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale, Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për tatimin në të korporatave dhe Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L091 për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 21, 30 nëntor dhe 5 dhjetor 2018

Kryetari konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura me datë 21, 30 nëntor dhe 5 dhjetor 2018, miratohet njëzëri, pa vërejtje.

Kryetari: Propozojë që të votohen raportet me amendamentet të Komisionit lidhur me Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe raportet të procedohen për shqyrtim të dytë në Kuvend.

Kryetari konstatoi se me 6 vota Për, 1 abstenim dhe asnjë Kundër, miratoi Raportet me rekomandime lidhur me Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe të njëjtat procedohen për shqyrtim të dytë në Kuvend.

Kryetari: Propozojë që në vazhdim të shqyrtohen pika 5-8 e rendit të ditës dhe pika shtesë shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L091 për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, dhe është fjala për Projektligjet dhe amendamentet e komisioneve funksionale që nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-097 për bibliotekat dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgaditur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-097 për bibliotekat, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/22 për kinematografinë dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgaditur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2004/22 për kinematografinë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgaditur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetari: Në bazë të Deklaratës Financiare të përgaditur nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave, ky projektligj nuk përmban implikime shtesë buxhetore. As amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L- 042 për rregullimin e shërbimeve të ujit, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L091 për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe amendamentet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 06/L091 për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimit të Projektligjit nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjen në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari: Unë kam kërkuar prej Ministrisë së Financave të bëjë një kosto financiare për Projektligjin për Dhomat e Posaçme të Gjykatës Supreme të AKP-së dhe Ministria e Financave ka treguar një kosto financiare për tre vitet e ardhshme 2019-2021 që është 1 milionë e 65 mijë e 908 euro për 28 pozita që nuk është përfshirë brenda ndarjeve buxhetore dhe ka rekomanduar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës koston shtesë si dhe numrin shtesë të pozitave ta përfshijë brenda projeksioneve buxhetore të planifikuara për vitin 2019-2021, dhe Ministria deklaroi se KGJK i ka 283 pozita të paplotësuara kështu që nuk ka nevojë që të shtohen pozita shtesë.

Naser Osmani: Kemi të bëjmë me një ligj që është vonuar dhe ministri i resorit përkatës ka kërkuar që të bëjë një seancë të jashtëzakonshme. E vërteta është që buxheti që është hartuar për vitin 2019 dhe kryesisht bazohen mjetet për investimet kapitale nga mjetet e AKP-së të cilat duhet të mirren pas procesit të likuidimit. Meqenëse Dhoma e Veçantë është autoriteti i fundit që bënë aprovimin e

raporteve për likuidim derisa ata nuk e kryejnë këtë proces dhe ato mjete nuk mund të derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës. Unë konsideroj që ligji duhet të procedohet sa më parë për votim nëse pozita i siguron votat. Në ligj është paraparë vetëm zëvendësimi i atyre gjykatësve që kanë qenë në shkallën e parë dhe të dytë ndërkombëtar.

Kryetari: Propozoj që rekomandimin e MF, ta përfshijmë në raport dhe të procedojmë tek komisioni përkatës funksional që ta kalojnë këtë ligj dhe ti rekomandojmë që ti shfrytëzojmë pozitave të aprovuara që i ka paraprakisht Këshilli Gjyqësor i Kosovës sepse ka pozitave të paplotësuar.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me 7 vota Për, 1 Kundër dhe Asnjë Abstenim, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmban kosto të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, koston shtesë buxhetore për zbatimin e Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të vlerësuar në shumë totale prej 1,065,908 euro, ta mbulojë nga ndarjet dhe projektionet buxhetore të planifikuara për vitin 2019-2021, dhe numrin prej 28 pozitave të reja, nga numri i pozitave të paplotësuar.
3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256

Besnik Tahiri: Ne të premtën e kaluar kemi marrur një shkresë prej kryetarit të komisionit për buxhet dhe financa për të prezantuar këtë ligj. Unë në pika të shkurtra do ti prezantojë. Ky ligj iu është nënshtruar një konsultimi të plotë dhe njëkohësisht ka marr mbështetjen dhe ka kaluar në Komisionin e Venedikut për vlerësim. Pra ligji përveç që iu ka nënshtruar konsultimeve, draftimit në nivel vendor ka pasur po ashtu edhe një shkallë tjetër ndërkombëtare në Komisionin e Venedikut ku janë bërë kryesisht zhvillimet që lidhen me fuqizimin e kontrollit financiar të partive politike. Në plotësim ndryshimin që e kemi bërë të këtij ligji, janë dy çështje kryesore: E para lidhet me nenin 5 ku flasin për kontributin e transferit bankar. Esenca është që secili transfer bankar për partitë politike të bëhet në mënyrë transparente të ketë llogari dhënie. Dhe e dyta lidhet drejtpërdrejtë me mandatin dhe çështjen që lidhet me daljen e më shumë se 6 deputetëve nga një parti politike. Çështja e tretë është kërkesa e Kryeministrit që iu lutë si komision për buxhet dhe financa për shkak të rëndësis që ka ky ligj në raport me procesin e stabilizimit asociativ që të i nënshtrohet një procedure të përshpejtuar në mënyrë që të kalon sa më shpejtë.

Kryetari: Po e hapi diskutimin për anëtarët e komisionit fillimisht nëse kanë për të thënë diçka në lidhje me propozimin e Qeverisë.

Naser Osmani: është një ligj që ka pasur shumë debate, sidomos me Zyrën e BE-së në Kosovë. Gjithmonë kanë qenë kërkesat që të ketë një transparencë më të madhe të shpenzimit të këtyre mjeteve dhe kemi kërkuar që partitë politike të paraqesin në faqen e tyre çdo të hyrë dhe të dalur dhe çdo llogari apo ndryshim të aktivitetit financiar që ndodhë tek partitë politike në raportet periodike dhe të iu dorëzohen KQZ-së. Ajo që sipas meje duhet mirë të analizohet është që auditori a ka të bëjë me kontrollin e mjeteve buxhetore apo ka të bëjë me kontrollin në të gjitha mjetet? Me qenë se kemi të bëjmë me subjektet politike, cili është mekanizmi që garanton që ai auditor nuk do të jetë i ngarkuar politikisht që në një moment të caktuar të përdorë ndonjë aktivitet jo shumë të qartë për ndonjë qëllim politik. Unë e kuptoj kërkesën e BE-së, por mendoj që nëse kalon leximi, nuk duhet të nxitohemi, duhet të marrim një model brenda BE-së që është më i përshtatshmi ta adoptojmë atë model të cilin përsëri duhet të vihet në diskutim dhe të kalojë.

Safete Hadergjonaj: Ne kemi një ligj shumë të rëndësishëm përpara, një ligj që e kemi pasur në komision disa herë. Jemi munduar të bëjmë ligjin më të mirë të mundshëm që të kenë partitë politike një qasje në financa por edhe me qenë transparente. Ajo çka mendoj që nuk ka funksionuar në periudhat e kaluara ka qenë që rekomandimet që na kanë ardhur nga BE-ja jemi detyruar të bëjmë pjesë të ligjit dhe e kemi bërë ligjin të pazbatueshëm dhe kjo ka qenë e keqja në të kaluarën.

Unë e di që ky ligj ka kaluar edhe përmes Komisionit të Venecias, mirëpo konsultat të cilat janë bërë me këtë komision nuk konsideroj që janë bërë në mënyrën e duhur pikërisht nga partitë politike sepse edhe partitë politike nuk e kanë marrur shumë me seriozitet apo nuk kanë qenë të informuar mirë se si po shkon ecuria e këtij ligji dhe nuk i kanë dhënë vërejtjet e duhura për këtë projekt ligj.

Në mandatin e kaluar kemi pasur shumë presion për çështjen e auditimit të partive politike sepse ka qenë pjesë e ligjit forma e auditimit të subjekteve politike, që faktikisht me ligj nuk kishte mundësi të plotësohen kushtet e ligjit për të pasur auditim të mirëfilltë të subjekteve politike. Prandaj jemi detyruar në komision të kemi zgjidhje të mëvonshme duke i ndarë mjetet shtesë në mënyrë që të ketë mundësi për të u bërë auditimi i subjekteve politike.

Unë edhe Naseri kemi qenë në takime edhe në BE, ku kemi diskutuar këtë projektligj dhe kemi kërkuar në njëfarë mënyre një analizë të mirëfilltë se si i kanë shtet e BE-së të rregullur këtë fushë. Por megjithatë ne duhet t'ia përshtatim rrethanave vendore sepse nganjëherë duke menduar që po bëjmë ligje krejtësisht në harmoni me BE-në po kemi shumë probleme brenda vendit të cilët nuk po kanë mundësi të zgjidhen dhe ligjet po bëhen të pazbatueshme. Unë mendoj që ne duhet të analizojmë këtë draft dhe mos ta procedojmë me nxitim dhe të ndalemi ta bëjmë një grup punues në komision ta analizojmë të kërkojmë ndoshta ndihmë dhe përkrahje prej të tjerëve që e njohin mirë këtë problematik në mënyrë që ta kemi një ligj të mirë dhe të zbatueshëm në të ardhmen.

Blerim Kuçi: Projektligji në fakt i ka kaluar të gjitha proceset normale edhe partitë politike e kanë pasur mundësinë me u kyçur dhe me dhënë kontributin e vet. Ne si Aleancë disa herë e kemi pasur në shqyrtim edhe jemi munduar së paku me dhënë kontribut. Ky është në parim edhe në mes të dy leximeve ne mundemi me dhënë kontributin tonë, kontributi ynë edhe amendamentet të cilat edhe Naseri i përmendi mundemi me dhënë mes dy leximeve.

Dardan Molliqaj: Mendoj që Qeveria duhet të analizojmë çështjen e harmonizimit të këtij projektligji me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave. Me ligjin për pastrimin e parave nuk mundet askush të bëjë më shumë se 1000 euro donacion brenda ditës. Qeveria e ka hequr këtë kufizim të financimit të partive politike. Me sa unë kuptoj ligji për pastrimin e parave është më i rëndësishëm se ky në këtë çështje dhe mendoj se duhet të ndërrojmë ligjin për parandalimin e pastrimit të parave pasi që po bie ndesh me njëri-tjetrin.

Çështje tjetër me rëndësi është çështje e auditimit ku auditori i përgjithshëm nuk i auditon mjetet që nuk janë të buxhetit të shtetit. Partitë politike janë një prej institucioneve që marrin buxhetin prej shtetit edhe donacionet private që vinë prej personave fizik ose juridik dhe ç'është e vërteta deri më tash nuk kemi

pasur fare auditim për shkak se komisioni për mbikëqyrje të financave nuk ka pasur mundësi të zgjedh një auditim.

Pajtohem me mendimin e z.Naser që auditimi mundet me u përdor prej cilit do prej neve dhe ti bëjë dëme të shumëllojshme një subjekti politik. Unë mendoj që auditori duhet ti auditojë edhe partitë politike. Problemi tjetër është problemi me donacionet Kosova si shumë vendet në zhvillim ekonomia e zezë është shumë e madhe, ne nuk kemi problem me raportimin e partive politike për buxhetin që e marrin prej shtetit që i ka marrë 100 mijë euro dhe duhet ti raportojë problemi është që partitë politike po marrin donacione të cilat nuk deklarohen prej bizneseve të cilat po ashtu nuk e kanë futur në të hyra fare dhe paraja që është në ekonomin e zezë kalon në financim të partive politike. Është një kufizim në ligj në bazë të numrit të banorëve sa mundet të shpenzojë partia politike.

Unë mendoj që çfardo shpenzimi që e bënë një kandidat i partisë është shpenzim i partisë sepse ai është kandidat i partisë dhe në këtë aspekt ato shpenzime duhet të futen në shumën e shpenzimeve të partisë. Kështu që ne duhet ta rregullojmë me amendament këtë çështje që edhe për shpenzime e kandidatëve duhet të jenë të llogaritura si shpenzime të partisë dhe po ashtu duhet të i rregullojmë si monitorohen shpenzimet e partive. Pjesa më e madhe e shpenzimeve janë ato që nuk raportohen, për ato shihen dhe ato që nuk shihen.

Arbërie Nagavci: Është jashtëzakonisht i rëndësishëm ky ligj, i cili ka kohë që tentohet të aprovohet, por pa sukses, që vërtet të mundësojë garantimin e transparencës në të hyrat dhe shpenzimet e financave të subjekteve politike dhe ne besojmë që drafti si i tillë nuk garanton që të arrihet kjo.

Në aspektin tjetër e cila u përmend si pikë e dytë nga z. Tahiri është edhe shqetësimi ynë në lidhje me nenin 2 që parasheh në rastet ku një subjekt politik pas vërtetimit të mandatit largohen 6 e më shumë deputet atëherë këta duhet të marrin mjetet nga subjekti që kanë qenë pjesë në një subjekt tjetër politik të regjistruar pranë KQZ-së. Ne mendojmë se kjo nuk është draftuar siç duhet. Në rradhë të parë nëse nisemi nga emërtimi i ligjit determinohet baza se kush janë entitetet që mund të përfitojnë nga fondi për demokratizim pra ligji është për financimin e partive politike dhe jo grupeve parlamentare si dhe ligji mbulon financimin e subjekteve politike që kanë fituar vende në Kuvend, ndërsa për financimin e subjekteve jo parlamentare parashihet të jetë një rregullim tjetër.

Një çështje tjetër që adresohet është se qartësohet burimi i të drejtës për përfitimin nga fondi për demokratizim të subjekteve politike është numri i vendeve që kanë fituar dhe jo numri i deputetëve që kanë fituar. Nëse e shohim Kushtetutën në nenin 64 përcaktohet se Kuvendi i ka 120 deputet të zgjedhur në votim të fshehtë bazuar në lista të hapura dhe se vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur në përpjestim me votat e fituara prej tyre në zgjedhjet e Kuvendit dhe po ashtu në linjë të njejtë edhe Ligji për zgjedhjet neni 111 e thekson se vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përcaktimit që ka bërë Kushtetuta në nenin 64.

Në këtë rast vihet re se vendet në Kuvend ndahen në mes të subjekteve politike, e dyta se ato duhet të jenë të çertifikuara nga KQZ-ja për zgjedhjet përkatëse, dhe e treta se vendet ndahen në bazë të numrit të votave që kanë marrë subjektet politike.

Në këtë aspekt, asnjë subjekt politik në kuptim të Kushtetutës dhe Ligjit nuk mundet të konsiderohet jashtë zgjedhjeve duke grumbulluar deputet individualisht, përderisa subjekti në fjalë nuk është çertifikuar nga ana e KQZ-së. Pra, deputet janë të lirë në mandatin e tyre në të gjitha çështjet sa i përket votimit, qëndrimeve të tyre e kështu me radhë por duhet të kemi parasysh se Ligji për financimin e subjekteve politike duhet të bazohet në Kushtetutën dhe Ligjin për zgjedhjet. Ne mendojmë se nuk është draftuar mirë dhe nuk e përkrahim në këtë formë.

Dardan Molliqaj: Besoj që kjo çështje duhet të shtrohet në bazë të argumenteve që i kanë palët sigurisht se do të ketë arbitër që do ti vendos të drejtën e kësaj pune dhe unë vetëm po mundohem të shpreh se ç'është e drejtë kushtetuese një gjë e tillë.

Janë dy lloje të interpretimeve që unë i vërej për grupet parlamentare sipas vështrimit juridik dhe Kushtetues të Kosovës. E para është që në grupet të cilat vinë si rezultat i zgjedhjeve dhe që përfundojnë

te themelimi i institucioneve edhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese mbi themelimin e institucioneve që për mua kap shumë pika të kontestuar flet që nuk mund të krijohen grupe të reja parlamentare para se të krijohen institucionet e Republikës së Kosovës, që nënkupton zgjedhja e kryetarit të kuvendit, Kryesisë së Kuvendit dhe Qeverisë.

Në bazë të rregullatives aktuale ligjore dhe praktikave në Kuvend, kur krijohet grupi parlamentar i ri, i gëzon të gjitha të drejtat e grupeve të tjera, pra zyrë, përfaqësim në komisione, përfaqësim në mbledhje të kryesisë, pra grupi parlamentar i ri është i barabartë me grupin e vjetër parlamentar dhe në të gjitha i lejohet grupit të ri parlamentar ti takojë një subjekt tjetër ose me kriju subjekt të ri.

Unë pajtohem me znj. Arbërie që ligji është ndryshe, por ligjet nuk mund të ndërrohen në kundërshtim as me ligjin në fuqi dhe as me Kushtetutën. Unë jam dakord që siç është ligji sot nuk i takon e drejta një subjekti që i krijon 6 deputet të marr fondet. Por unë mendoj që kjo duhet të rregullohet ndryshe ngase ka një problem logjik dhe juridik në këtë çështje dhe po ashtu mendoj që mirë është ta mbështesim.

Ali Lajçi: Ky ligj është bukur shumë delikat apo sensitiv. E kemi përcaktimin e buxhetit në baza partiake. Tani këtu kemi një problematikë e cila nuk është përcjellur mirë në bazë të pjesës së kodifikuar të përcaktimit ligjor i cili do të ishte i saktë dhe do të ishte normë në secilën nga këto pozicione. Tani grupet tjera që dalin, derivojnë nga një subjekt tjetër kërkojnë dhe duan të kenë pjesën e buxhetit por është edhe një çështje që nuk është definuar mirë, a mund të ndodhë që buxheti tash të transferohet prej një subjekti në një tjetër i cili deputet mandatin e ka marrur të një parti politike ku legjitimiteti burimor është atje dhe tash ky legjitimitet burimor tjetërsohet dhe kalon në një akronim apo në një grup të pavarur politik. Kjo është një temë e cila nuk është adekuate ligjërisht dhe kjo duhet të rregullohet. Por deri tash praktikat nuk e kanë lejuar transferin e legjitimitetit bashkë me buxhetin dhe unë mendoj se ky kaptull i kësaj pjese nuk është shumë i preferueshëm, prandaj do një trajtim më seriozë në kuptim.

Arbërie Nagavci: Në aspektin administrativ KQZ-ja mer vendim për ndarje të buxhetit në fillim të çdo viti dhe ndryshimet që mund ndodhin në periudha të caktuara të vitit nga deputet të caktuar do të thotë sjell një situatë e cila bie në kundërshtim me atë që është planifikuar nga KQZ-ja. Në anën tjetër nëse e shikojmë se si kjo adresohet kur kemi të bëjmë me shkëlqje të deputetëve apo kandidatëve gjatë zgjedhjeve e dimë që të gjitha masat ndëshkimore financiare i faturohen subjektit politik e jo individëve të caktuar.

Në rastin tjetër një element që dua ta përmend mund të bjerë në kundërshtim me Kushtetutën situata si këto ku bëhet fjalë për një parti politike për shembull e shohim rastin e deputetëve që janë larguar nga LVV tani ata janë me emërtimin PSD dhe ne e dime se PSD ka qenë pjesë e koalicionit të PAN-it. Pa ndonjë qëllim por po e adresojë një çështje reale kur kemi disa deputetë të cilët bëhen pjesë e një subjekti politik të cilët kanë kandiduar me një koalicion që ka edhe qëndrime edhe programe tërësisht të ndryshme prej atij të cilit ka fituar në zgjedhje, për këtë arsye ne mendojme dhe nuk e perkrhim si të tillë sepse mund të sjellë një situatë të cilat nuk janë të mira as për zhvillimin e demokracisë, por as për qëllimin e vetë ligjit.

Albulena Haxhiu: Siç po e shihni në fletën e parë të tij me një projektligj janë ndryshuar dy ligje për financimin e subjekteve politike dhe në anën tjetër Ligji për zgjedhjet e pergjithsme të Republikës së Kosovës dhe kjo proceduralisht është në kundërshtim edhe me Rregulloren e Punës. Përveç ligjit për përmbylljen e procesit të mbikëqyrjes së pavarësisë, nuk kemi pasur ndonjë ligj tjetër që i ndryshon dy ligje të ndryshme.

Po ndalem në disa çështje: e para është e vërtetë që ky projektligj parasheh disa ndryshime më të avancuara sidomos tek definimi i kontributit që është një definim më i qartë, sidomos dispozita ku thuhet rreptësisht ndalohen pranimi i kontributeve anonime. Ndërkaq, në anën tjetër përmban probleme, gjegjësisht tek neni 2.2. që flitet për ndarjen e buxhetit për largimin e 6 apo më shumë deputeteve nga një subjekt politik, sigurisht që po kjo nuk ka logjikë dhe është absurde dhe është në

kundërshtim me Kushtetutën, madje është në kundërshtim edhe me aktgjykimin e vet Gjykatës Kushtetuese që e definojnë se çka nënkupton grupi parlamentar.

Siç e tha edhe znj. Nagavci në momentin kur çertifikohen zgjedhjet paratë ndahen për subjektin politik varësisht nga përbindja që e kanë fituar në zgjedhje dhe ka qenë me heret që është ndarë për kokë deputeti dhe tash nuk ndahen për kokë deputeti por për subjektin politik dhe mënyra se si është procedura është absolutisht e papranueshme dhe në këtë kuptim është mirë që z. Tahiri me na njoftu që projektligji pse njëherë është votuar në Qeveri apo jo pastaj është terhequr dhe është futur kjo me kërkesë të PDS-së, por nuk ka problem sepse nëse mbetet kështu ne do ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese, pastaj pasojat i bartni ju që po bëni pazare me ligje të tilla.

Pastaj kur jemi të çështja e auditoreve është e vërtetë që ka mjaftë probleme në mënyrën se siç është shkruar do të thotë nuk siguron që auditorët nuk do të veprojnë në përputhje me kompetencat e tyre, por edhe një absurd i radhës që do të thotë kur definohet se kush do të jetë auditor të mos ketë ngritur aktakuzë tash ky rregullim nuk është në asnjë prej ligjeve tjera vendore.

Por ne e dimë se si funksionon sistemi drejtësisë në vendin tonë brenda sekondit mund ti ngritet dikujt aktakuzë veq pse dikush ka dashur, pra ky nuk është rregullim që ne mund ta gjejmë tek ligjet tjera apo aktakuzë veprat penale të korrupsionit.

Është e vërtetë që ka kolizion me ligjet tjera bie ndesh me disa raste me kodin penal, madje ne disa raste ndërhyjnë edhe ne vet gjykatat atë kesaj zyrës për financa, drejtorisë gjëgjesisht i jepen kompetencat e gjykatave.

Safete Hadergjonaj: Projektligji për financimin e subjekteve politike gjithmonë është trajtuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional. Sa i përket pjesëmarrjes së deputetëve në punën e komisionit secili deputet ka të drejtë që të marrë pjesë në komision, ka të drejtë edhe të marrë fjalën për të diskutuar, por nuk ka të drejtë të votojë dhe të drejtë për të votuar kanë vetëm anëtarët e komisionit. Sa i përket frymës së komisionit, nuk mundet askush të na e bartë një frymë tjetër sepse e dimë se ky komision ka pasur një frymë shumë pozitive në drejtim të çuarjeve përpara për çështjet që kanë pasur interes.

Dardan Molliqaj: Është e vërtetë dhe pranoj edhe publikisht sepse ka qenë kërkesë e PSD-së kjo. Nuk ka asnjë problem ndryshimi i ligjit sa i përket Kushtetutes, dhe jam i bindur për këtë punë.

Fondi ndahet për numrin e vendeve në Kuvend për subjektet politike, përbindja e saktë dhe kështu duhet të mbetet. PSD-ja është subjekt politik që e njih Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nuk jemi deputet të pavarur. Ne do ta propozojmë një amendament që kerkojmë që në momentin të cilin ligji hyn në fuqi të zbatohet edhe në këtë mandat të Kuvendit. Këtë çështje kemi me dergu në Gjykatën Kushtetuese, kemi raste të veprimit prapaveprues të ligjit dhe kemi raste kur nuk janë lejuar gjëra të tilla.

Safete Hadergjonaj: Ju kisha lutur deputetëve që debatim që e kemi në mes të dy subjekteve politike të mos e bëjmë temë tani në Komisionin. Ne e kemi ligjin në lexim të parë të shohim se çfarë mund të punojmë më tutje që më i zgjedhë problemet brenda Kuvendit. Dardani e tha shumë mirë se kjo gjë mund të ndodhë edhe në të ardhmen pra duhet ta bëjmë një zgjidhje këtij problemi.

Albulena Haxhiu: Do të thotë se pari është e vërtetë që me rregullore na lejohet që secili deputet me shku në çfarëdo komisioni dhe ku me marrë deputet tjerë që me shku në komisione tjera sepse diskutohen çështje tjera të rëndësishme. Me vjen keq nese ju pengon por e kam të drejtëm me rregullore po ashtu jeni të ftuar vazhdimisht në mbledhjet e komisionit për legjislacion dhe aq me mire nese vini. E dyta ne nuk po themi që disa deputet që largohen nga një subjekt politik mos të kenë të drejtën e financimit, por absolutisht jo financat që i takojnë një subjekti në bazë të vendeve apo përbindjen që e ka fituar në zgjedhjet e fundit.

Ne po flasim në parim dhe kjo nuk ka fuqi prapavepruese dhe nëse kjo kalon edhe njëherë po themë që e dërgojme në Gjykatën Kushtetues. Tjetra hallin ne e kemi që kjo pastaj stimulon edhe trafikim e deputetëve me arsyetimin se po dalim në një grup sepse i marrim parat me gjashtë deputetë.

Enver Hoti: Duhet ta kalojmë këto situata që të mos hyjmë në analizën dhe kuptimin se ndarja e subjektit në fondin për demokratizim duhet të zhvendoset ndoshta nga autoritarizmi tani dalim në temën tjetra.

Besnik Tahiri: Me lejon t'iu falënderoj për dy arsye. E para se i gjithë debati ishte përmbajtësorë dhe sillej rreth dy temave kyçe atë etë financimit dhe atë që ngrihet z.Lajci të legjitimitetit të mandatit dhe raportit në mes të subjektit dhe partisë. Pra do të thotë janë dy elemente për të cilat ju keni mundësinë gjatë gjithë kohës ta amendamenti me fuqinë tuaj.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja e parë e komisionit, konstatoi se Komisioni me 6 vota Për, 2 Kundër dhe 1 Abstenim, nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë parim Projektligjin nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058 dhe Ligjin nr.04/L-122, si dhe Ligjin nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256.

10. Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2019

Safete Hadergjona: Siç e dini Fondi i Kursimeve Pensionale për çdo vit vjen me kërkesë për ta miratuar taksën vjetore dhe në bazë të kësaj takse harton buxhetin për investimin e mjeteve dhe për shpenzime operacionale.

Ruzhdi Morina: Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi ashtu sikur se parashohin Fondi i Kursimeve Pensionale e ka proceduar propozimin për miratimin e taksave, që taksa menaxhuese operacionale dhe taksën investive, të cilat nuk kanë ndjekur tregun e vazhdueshëm të një zbritjeje në përputhje proporcionalisht me fondin. Për vitin 2018, taksa investive ka qenë 0.381% që i bie më pak se 0.5% apo 0.4% ndërsa për vitin 2019 ka pësuar një rënie të ndjeshme sa i përket përqindjes, por natyrisht ka një rritje nominale të ndjeshme për shkak të rritjes së masës së parasë.

Megjithatë, sa i përket taksës investive, duke pasur parasysh se vitin e fundit ne jemi fokusuar kryesisht në investime brenda vendit ka pasur një deficit të caktuar të cilin në përputhje me rekomandimet e juaja të mëhershme e kemi kthyer në fond. Pra për vitin e ardhshëm sa i përket taksës së investive ne kemi paraparë 0.37% ndërsa në vlerë nominale 6.795.000 euro, sa i përket taksës operacionale është një ndër shtojcat më të ulëta në nivel global dhe nga 0.71% sa ka qenë për vitin 2018, ka pësuar një rënie të ndjeshme në 0.69% për vitin 2019 apo shprehur në vlerë nominale është rreth 1.3 milion.

Mënyra se si ne e kalkulojmë apo se si vijmë deri tek këto propozime është zakonisht në bazë të disa parametrave duke pasur parasysh mjetet që i kemi nën menaxhim të cilët i parashikojmë të hyrat që vijnë nga kontributet pensionale dhe mjetet që tërhiqen nga ata që dalin në pension vijmë deri tek një shumë mesatare të cilën e kemi nën menaxhim gjatë vitit dhe mbi bazën e kësaj ne kalkulojmë këto tarifa. Për vitin 2019 shuma mesatare që pritet të jetë nën menaxhim pritet të jetë 1.8 miliard euro. Sa i përket detajeve tjera rreth buxhetit apo cila është kompetencë e bordit e cila është një mekanizëm mbi bazën e të cilës ju i vlerësoni këto taksa, janë bashkangjitur në këtë dokumentacion dhe i kishim lënë më shumë hapësirë për sqarimet që janë të nevojshme se sa të marrim kohë me paraqitjet në detaje.

Arbërie Nagavci: Unë kisha një pyetje sa i përket investimeve, nëse i kuptova drejtë thatë se ka pas një rënie sa i përket investimeve dhe se ka suficit, a mund të na tregoni se cili është shtimi në investim? Sa është kthimi në investime të mjeteve pensionale?

Naser Osmani: Pyeti sa është rritur shuma në vlerë absolute e mjeteve të trustit? A është rekomandimi i Komisionit për zvogëlimin e buxhetit në emër të zvogëlimit të pagave të menaxhmentit të Fondit, sipas kërkesës së Komisionit?

Ruzhdi Morina: Tek buxheti operacional 1 milion e 343 mij euro kanë qenë për vitin 2018 dhe 1 milion e 332 mij është për vitin 2019, ka një zbritje prej 10,000 euro

Sa i përket pyetjes t a është përfshirë rekomandimi i komisionit për zvogëlimin e pagave dhe buxhetit , natyrisht që është përfshirë tek buxheti për vitin 2019 dhe kjo shihet tek shpenzimet e personelit që është -3.8%.

Pastaj kur dalim te buxheti, përveç tek mirëmbajtja softuerike, të gjitha të tjerat janë me zbritje aq sa kemi mundur sepse jemi në kufi të funksionimit, kjo nuk do të thotë që në të ardhmen do të jemi këtu sepse ne kemi planet tona strategjike që të zhvillojmë resurset e brendshme të fondit sepse e dini se të gjitha investimet bëhen përmes astevemenaxherëve dhe në të ardhmen fondi duhet të jetë në gjendje që të bëjë vet investime. Legjislacioni mundëson që disa investime të bëhen vet por në fillim ne duhet ti rrisim kapacitetet pra në të ardhmen do të ketë një rritje të ndjeshme sigurisht në koordinim me komisionin dhe mbikëqyrësin e fondit që është BQK.

Sa i përket investimeve që është çështja kryesore e jona do ta diskutojmë kur të vijë raporti vjetor do ti marrim të gjitha rezultatet dhe do të jetë një informacion i përgjithshëm, dhe ky vit do të jetë të themi një vit jo i mirë për fondin për shkak sepse ne jemi të ekspozuar në tregjet financiare, përkundër faktit që ne duhet ti paraprijmë më tepër sepse nuk kemi bërë një asnjë investim jashtë vendit të gjitha jemi koncentruar ti kthejmë në letra me vlerë të Qeverisë dhe është e vetmja mundësi që të bëjmë investime në vend. Por mjetet janë të ekspozuara jashtë, dhe lufta tregtare SHBA-Kinë dhe në aspekte tjera kanë ndikuar që ky vit do të përmbillet me një rënie të lehtë të vlerës.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja e parë e komisioni , konstatoi se Komisioni me 5 vota Për, asnjë Kundër dhe 2 Abstenime, nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për caktimin e taksës investive prej 0,37% dhe taksës operationale prej 0,069%, për vitin 2019.

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2017

Safete Hadergjonaj: Kërkojë nga përfaqësuesit e Agjencisë të bëjnë prezantimin e raportit financiar.

Florije Kika: Sqaroi se arsyeja pse raporti vjetor nuk është paraqitur në afatin e përcaktuar me ligj ka qenë për shkak të mosfunksionimit të bordit. Me funksionalizimin e bordit, në mbledhjen e mbajtur me datë 01.11.2018 bordi ka aprovuar raportin vjetor të Agjencisë për vitin 2017.

Sa i përket raportit financiar kërkesa e parë buxhetore e Agjencisë ka qenë 6.324.613 mijë euro dhe nga kjo kërkesë e ligjit për buxhetin është miratuar buxheti prej 2.609.658 mijë euro, mirëpo gjatë viti 2017 ky buxhet është reduktuar në bazë të vendimeve të Qeverisë. Nga kjo shumë buxheti final ka qenë 1.795.308 euro dhe nga kjo shumë realizimi i buxhetit është prej 1.697.142 euro apo në vlerë prej 94.53%. Ndër arsyet pse janë reduktuar këto mjete financiare ka qenë për shkak se Qeveria ka marrë

vendim se projektet të cilat nuk janë realizuar deri në qershor diku rreth 85% të gjitha institucioneve janë reduktuar.

Ndërsa sa i përket pjesës së dytë të vendimit të Qeverisë lidhur me skemën e kompensimit me ligjin për buxhet janë ndarë 300 mijë euro skemës së kompensimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, mirëpo ka qenë e pamundur sepse nuk ka ekzistuar një bazë ligjore që këto mjete financiare sepse në bazë të procedurave duhet të ndahen në fondin e mirëbesimit. Andaj për këtë arsye në Ligjin për buxhet për vitin 2018 është paraparë një paragraf i veçantë për këtë fond dhe shuma është rritur nga 300mijë në 600 mijë dhe janë bartur për vitin 2018. Ndërsa vendimi i tretë për projektet kapitale ku është reduktuar për 80% ka qenë për shkak sepse nga vlera e parë e projektve kapitale që ka qenë është reduktuar prej 80% dhe ka mbetur vetëm pjesa tjetër pre 98% dhe për shkak të procedurave tenderike dhe ankesave të cilat janë paraqitur nuk kanë mundur të kryhen brenda aftit të paraparë.

Arvita Zyferi: Opinioni i auditimit për vitin 2017 për Agjensinë ka qenë i pamodifikuar, ndërsa sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit në përgjithësi kemi vërejtur se ka pasur progres ka pasur përmirësime nga viti paraprak, megjithatë gjatë auditimit ne kemi vërejtur disa mangësi të cilat do ti përmendim.

Qysh prej vitit 2014, Agjensioni është duke mbajtur pozita me ushtrues detyre, pastaj dobësi tjetër është vërejtur në planifikimin e projektve kapitale, ku prej 4 projektve që janë planifikuar në fillim të vitin vetëm 1 është realizuar dhe atë vetëm disa pagesa prej 3.495 eurove pjesa tjetër është kthyer në buxhet. Ministria e Financave i ka tërhequr mjete pasi që nuk janë realizuar procedurat. Po ashtu mangësi tjetër është vërejtur edhe mungesa e komitetit të auditimit. Gjithashtu kemi vërejtur dobësi edhe tek harmonizimet bankare, megjithëse ka progres prej një viti më herët por këtë vit është vërejtur një diferencë e vogël ku nuk është barazuar Banka Qendore me SIMFK-në për rreth 7.300 euro.

Sfidë për agjensionin që ne e kemi ngritur si çështje ka qenë përmbushja e misionit dhe objektivave të tyre për shkak të mungesës së bordit mbikëqyrës si dhe në mungesë e dy komisioneve, komisionit për verifikim dhe vendosje të pronave dhe komisioni për kërkesa pronësore.

Agjensioni në përgjithësi ka bërë progres në zbatimin e rekomandimeve të auditorit, ku 11 prej rekomandimeve 7 janë zbatuar, 2 kanë qenë në proces të zbatimit deri në periudhën ku ne kemi qenë në auditim dhe 2 prej tyre nuk janë zbatuar ende. Në këtë raport kemi edhe 6 rekomandime dhe Agjencia është pajtuar me përmbajtjen e raportit përmes letër konfirmimit.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Zëvendëskryetarja e parë e komisioni , konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisioni

Zëvnedës-kryetarja e parë e komisionit

Safete Hadergjonaj